



**VENDIM**

***Nr. 112, Datë 22.09.2015***

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“STRELCA ENERGY” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “STRELCA 1” ME FUQI TË  
INSTALUAR 1504 KW, “STRELCA 2” ME FUQI TË INSTALUAR 325  
KW DHE “STRELCA 3”, ME FUQI TË INSTALUAR 3520 KW (ME  
FUQI TOTALE TË INSTALUAR 5349 KW)**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.09.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “STRELCA ENERGY” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec-et “Strelca 1”, “Strelca 2” dhe “Strelca 3”,

**Konstatohet se :**

Aplikimi i shoqërisë “STRELCA ENERGY” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

**Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:**

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
  - Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3),
- do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/ të Pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për liçensimin e shoqërisë “STRELCA ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Strelca 1” me fuqi të instaluar 1504 kW, “Strelca 2” me fuqi të instaluar 325 kW dhe “Strelca 3”, me fuqi të instaluar 3520 kW. (me fuqi totale të instaluar 5349 kW)
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**